



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Erasmus + SOCRE

Plani i Cilësisë së Projektit

Më poshtë mund të gjeni veprimet e ndryshme në Planin e Cilësisë. Monitorimi dhe kontrolli i brendshëm i cilësisë ngërthyer në të gjitha aktivitetet e projektit.

Qëllimi është të sigurohet që projekti të përmbushë objektivat e saja në kohën e planifikuar. Për më tepër, procedurat e kontrollit të cilësisë përmirësojnë bashkëpunimin në mesin e aktorëve, si dhe metodat e kontrollit të cilësisë të përdorura gjatë projektit mund të zbatohen për zhvillimet pas projektit të kurseve të ZHVP. Niveli i lartë i cilësisë arrihet përmes monitorimit të rregullt të të gjitha proceseve të PP dhe outputeve. Metodë kryesore është aplikimi i vlerësimit të fuqizimit, i cili për nga natyra është proaktiv dhe përmirësues.


Ekipi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga përfaqësues të AHS, Metropolia, SPbMSI dhe UGJFA. Ekipi bashkëpunon me grupin drejtues në zbatimin e procedurave të kontrollit të cilësisë, duke përfshirë modifikimin e tyre, nëse është e nevojshme. Do të sigurohen edhe Informacionet përcjellëse të hapave të caktuar që çojnë në outpute, e po ashtu edhe cilësia e tyre. Metodat përfshijnë listat e kontrollit, procesverbalet e takimeve, vlerësimet kolegjiale dhe vlerësimet e fuqizimit.



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



1. Vlerësimi i fuqizimit sipas proceseve dhe produkteve të projektit. Vlerësimi i fuqizimit fillon në një fazë të hershme të procesit si masë proaktive, gjatë planifikimit të parakushteve.
 - a. Ne planifikojmë të përdorim një 'sistem hibrid': proces i vazhdueshëm me matje të cilësisë



2. Opinioni i partnerëve
 - a. Anketë: bërë në aktivitete/takime të ndryshme. Ne vazhdojmë të bëjmë anketa për çdo aktivitet. Ekziston një formular i google që do të plotësohet nga secili pjesëmarrës pas çdo takimi/vizite studimore/vizite të tutorit. Rezultatet do të përdoren për të përmirësuar ngjarjen tjetër.
 - b. Blogjet: Blogjet janë një pjesë e platformës digjitale. Ato do të përdoren për të filluar një diskutim në grupet rajonale, si dhe për të dhënë reagime më cilësore. Përmbajtja e këtij blogu përdoret kryesisht për të përmirësuar bashkëpunimin në grupet e studimit.
3. Vlerësimi i rezultateve dhe mbi progresin e projektit
 - a. Lista kontrolluese bazuar në matricën e çdo pakoje të punës, në çdo grup të studimit. Për çdo aktivitet të PP (Pako e punës) dhe output të PP, planifikohet një listë kontrolluese para se të fillojë PP në bashkëpunim me konzorciumin dhe aktorët e PP.
 - b. Raporti i progresit të grupeve të studimit: Kjo i është shkruar grupit drejtues (1 dokument) për të dhënë reagime mbi statuskuonë e grupeve të studimit.
 - c. Sistemi i shqyrtimit kolegjial: sistem i përbashkët i zhvilluar midis partnerëve. Qëllimi është që të ndihmohen partnerët për të vlerësuar rezultatet e zhvilluara.

- d. Raportet për monitorim periodik do të prodhohen dy herë në vit nga ekipi i brendshëm i vlerësimit të projektit, i raportohen grupit drejtues dhe publikohen në platformën digjitale.
4. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë
- a. Eksperti i jashtëm përdoret për të fituar njohuri rreth asaj se si përmbushen objektivat e projektit dhe për të trajtuar çdo problem sapo të ngritet.
 - b. Fokusi kryesor është mbi cilësinë e kurseve të ZHVP, cilësinë e bashkëpunimit dhe zhvillimit rajonal dhe cilësinë e menaxhimit, zbatimit dhe shpërndarjes së kurseve të ZHVP.
 - c. Të gjitha përmbajtjet e prodhuara dhe materialet e cilësisë do të ndahen me vlerësuesin e jashtëm, i cili do të vizitojë të dy vendet e PA gjatë vitit të dytë dhe të fundit të projektit. Vlerësuesi i jashtëm do të japë reagime, duke i raportuar organizatës koordinuese Metropolia UAS, si dhe duke marrë pjesë në disa nga takimet e grupeve të cilësisë. Metropolia UAS do t'i shpërndajë të gjitha raportet e vlerësimit të jashtëm grupit të cilësisë, grupit drejtues dhe pjesëmarrësve të tjerë të projektit..

Metoda kryesore në të është e shpërndarja në mënyrë efektive e outputeve (përshkrimet e kursit të ZHVP), duke i publikuar ato në Prishtinë dhe në konferencën e Shëndetësisë në Shën Petersburg në vitin 2019, si dhe autoriteteve të qytetit për të marrë reagime.